

Anija gjigande në kalatën lindore, përpunimi brenda dhe jashtë basenit.

03.10.2011



Një anije e tonazhit të madh është ankoruar në mesnatën e së shtunës në portin e durrësit.

Burimet zyrtare nga Autoriteti Portual Durrës bëjnë me dije se anija me flamur norvegjez “Vela” do të ngarkohet me 52 mijë ton mineral hekuri dhe ka për destinacion Kinën. Përpunimi përbën një operacion të llojit të veçantë dhe përgatitjet e tij kanë nisur gjashtë muaj më parë.

Pjesa e parë e ngarkesës prej 24.5 mijë ton do të përpunohet në kalatën 11, ku dhe thellësia e basenit është më e madhe (11 metra). Pjesa e parë e ngarkesës pritet të përfundojë në orët e vona të ditës së sotme (e hënë).

Ndërkaq në kalatën 7 ka përfunduar brenda 30 orësh procesi I ngarkimit të një anije **feeder** 10 mijë tonëshe dhe është duke pritur anijen e madhe “Vela” në radën e portit. Anija e dytë **feeder** është duke u ngarkuar në kalatën 7, për të lëvizur më pas drejt radës portuale. Më pas anja tregtare “Vela” do të spostohet në radë për të vijuar procesin e ngarkimit përmes dy anijeve ndihmëse **Feedera**.

Realizimi I këtij procesi është një arritje shumë e madhe për Portin e Durrësit dhe për eksportet nëpërmjet tij, pasi ky proces lidhet me koston e transportit dhe I bën mineralet shqiptare më tërheqëse për tregun e huaj.

Ky proces po menaxhohet me sukses në bashkëpunim të plotë mes portit të durrësit dhe kompanisë ASC, që ka marrë përsipër organizimin e operacionit portual, çka përbën një fazë të re zhvillimi. Burimet portuale shtuan se kjo metodë e përpunimit do të përdoret në ngarkesat e mëdha “Made in Albania”, deri kur të realizohet projekti I thellimit të basenit dhe kanalit hyrës në portin e durrësit.

Sipas të dhënave nga pronarët shqiptarë të mallrave pritet që sot drejt portit të nisen rreth 100 mijë ton të tjera, eksportimi I të cilave do të realizohet në dy muajt e ardhshëm.

Realizimi me sukses I këtij procesi rrit pozicionin konkures të portit të Durrësit në rajon dhe e ve Autoritetin Portual përballë realizimit të sfidave të reja që kanë lidhje me rritjen e kapaciteteve përpunuese si dhe zbatimin e projektit të thellimit të basenit dhe kanalit hyrës të tij.



